



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16945/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Makfire Osmani, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 I Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publike, e ne bazë të nenit 73,74,195, si dhe nenit 198 al.l.pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të përmendurit Mafire Faik Osmani e lindur me 13.03.1962 në Prishtinë ku dhe tani jeton "Ulpiana" sol 3 nr 35, për kundërvajtjen nga neni 16.paragrafi 1.1. I ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik. Pezullohet procedura konform nenit 198.al.l.pika 8 të LMK-së, në në mungesë të provave Shpenzime të procedurës nuk ka patur. Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dërguar pales dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia kundër korrupsionit, parashtror kërkesën 01-2326/10 të dt. 08.06.2010, për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të përmendurit me lartë, dhe për kundërvajtjen të sanksionuar sipas ligjit të cituar më lartë. Gjyqtari zhvilloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehuren e cila deklaroi, me dt. 30.06.2010, jam punëto e inkuadruar në kompanin e ujrave "Prishtina" në Prishtinë dhe sipas ligjit për deklarimin dhe perjarjen e pasuris dhe dhuratave publike kam qenë e obliguar të mbushi formularin për deklaraten e pasuris. Në kohën kur ka ardh shkresa, formulari unë kam qenë jasht Shtetit në shërim sepse unë jam e prekur dhe e sëmuar nga kanceri. Se kjo qendron kështu gjykatës i prezentoj shkresat e shërimit tim në Londër, Raportin Mjekësor të spitalit dhe kohën e qendrimit tim të përcjelljes së diagnozës prej dt.30.03.2010, gjerë më dt. 28.04.2010, se kjo qendron kështu Gjykatës jap edhe pasaportën e kthimit tim në Republikën e Kosovës me dt. 06 qershor 2010, që është e vërtetuar në faqen 10 dhe 3, ku jan shenuar të dhënat e identifikimit tim dates së arritjes në vendlindje si dhe shkresat nga diagnoza e shkruar nga Qendra Klinike Univerzitare të fletëlshimit Dr. Zhuri si dhe kolegjiimi i mjekëve Dr. B.Osmani Dr. Nexhat Pllana, Dr. Premtim Rashiti, dhe data e përcjelljes nga ana e mjekëve ka qenë që nga dt. 30.10.2009, deri më dt. 12.02.2010, kurse nga kjo date kam qendruar në Londër si paciente e trajtimit të rregullt mjekësor, andaj këto kan qenë shkaqet të cilat kan ndikuar për mos kryerjen e obligimit tim personal për plotësimin e formularit kundër korrupsionit prejardhjen e pasuris dhuratave të zyrtarëve të lartë publik.

Gjithashtu gjykatës I prezentoj dëshmi të operimit tim në Beograd me dt. 14.10.2009, të dr. M.Iliq, si dhe diagnozën e sëmundjes patologjike dhe Raportin e Qendrës specialistike të Prishtinës.

Për vëretimine gjendjes faktike gjykata ka dëgjuar përsosin e autorizuar Afrim Atashi, me dt. 30.06.2010, i cili deklaroi, se Makfirete Osmani është në regjistrin e përsosave që duhet të plotëson informatën për ate që kemi kërkuar për deklarimin e pasuris, mirëpo të dhënat që i ka prezentuar në gjykatë se ka qenë e sëmuar ne nuk kemi pasur informatë se në kohën kur është dashur të pranojm pyetsorin ne nuk kemi pasur informata, andaj lidhur me këtë gjykata të vendos në bazë të provave të prezentuara nga agjensioni kundër korrupsionit dhe pala që prezenton në gjykatë.

Me dëgjimin e të pandehures Makfirete Osmani ushtruesit të fletëparaqitjes shkresave të prezentuar në kërkesë si dhe dëshmime të ofruara në intervalin kohor nga data 14.10.2009, gjerë më dt 06 qershor 2010, gjykata konstatoj se e lartëpmmendura ka qenë e prenguar nga sëmundja e cila e ka kapluar të të pandehuren dhe e njejta ofroi dëshmi gjykatës se mos plotësimi i formulareve për çka e ngarkon kërkesa ka qenë si pasojë e pengimit – "Vis Major", e jo për shkak të neglizhencës përsosale ashtu siq e rëndon kërkesa për çka gjykata conform nenit